

**AKT THEMELIMI DHE
STATUTI
SHOQERISE AKSIONARE**

"Dream Auto Tirana" sh.a.

**KREU I
EMRI, FORMA, SELIA, KOHEZGJATJA**

**Neni 1
Forma, Emri i Shoqerise dhe Percaktime**

1.1. Kjo shoqeri ka formen e shoqerise aksionare dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me dispozitat e Ligjit (si eshte percaktuar me poshte), me legjislacionin shqiptar ne fuqi, si dhe me ndryshimet e tyre te here pas hereshme.

1.2. Emertimi i shoqerise eshte "Dream Auto Tirana" sha.

1.3. Ne kete statut, termat e meposhtem do te kene kuptimin e percaktuar ne vijim:

- (i) **"Ligji"** do te thote Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqeritetregtare", i ndryshuar;
- (ii) **"Shoqeria"** do te thote **"Dream Auto Tirana" sha**;
- (iii) **"Statuti"** do te thote statuti i Shoqerise.

**Neni 2
Selia**

2.1 Selia e shoqerise ne momentin e miratimit te ketij statuti eshte ne adresen:

- **Rruga Industriale Dytesore Vore, Ndertese me Nr Pasurie 132/14/3, Zona Kadastrale 2183, Koder Vore, Vorë, Shqipëri.**

2.2 Shoqeria ka te drejte te ndryshoje seline e saj ne nje adrese dhe/ose ne nje qytet tjeter te Republikes se Shqiperise. Shoqeria, me vendim te Keshillit te Administrimit, mund te hape dege te saj ose zyra perfaqesimi kudo brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise.


**Neni 3
Kohezgjatja**

3.1 Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar.

**Neni 4
Objekti i Shoqerise**

4.1 Shoqeria do te kete objektin tregtar te meposhtem:

- Tregtim automjesh te cdo lloji, tipi dhe tonazhi, te reja ose te perdorura. Import, eksport automjesh per llogari te vet dhe per te tretet brenda dhe jashte territorit te vendit.
- Tregtim te cdo lloji malli qe ka te beje me cdo lloj automjeti qe eshte ne qarkullim, perfshire goma te cdo lloji, paisje e pjese kembimi per lavazh, etj.
- Dhenien me qera te automjeteve te cdo lloji dhe cdo veprimtari tjeter te mundeshme ne permbushjen e ketij qellimi.
- Krijimin e te gjithë infrastruktures per te ofruar sherbime ne lidhje me permbushjen e te gjithë procedurave te nevojshme qe duhet te kryhen nga ana e pronareve te mjeteve motorike per paisjen me te gjithë dokumentacionin perkates te mjeteve te tyre motorik.



KREU II **KAPITALI I REGJISTRUAR / AKSIONET**

Neni 5

Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar, aksionet dhe aksionerët e shoqërisë

5.1 Kapitali i regjistruar i Shoqërisë, ne momentin e miratimit te ketij Statuti, eshte 10,000,000 (dhjete milion) leke, i perbere nga 10,000 (dhjete mije) aksione, me vlere nominale 1,000 (nje mije) leke secili aksion.

5.2 Aksioneri i vetem i shoqërisë në momentin e miratimit të këtij Statuti eshte si më poshtë:

- Shoqëria “Arch Investor” sh.p.k, me seli në Rruga “Ismail Qemali”, Nr. 32, kati 3, Njësia Bashkiake numër 5, Kodi Postar 1019, Tiranë, me NUIS K91404015I, e cila zotëron 100% (njqind perqind) te aksioneve.

Neni 6

Shlyerja e aksioneve

6.1 Ne momentin e miratimit te ketij statuti, te gjithë aksionet e emetuara si me siper jane nenshkruar plotesisht dhe jane shlyer ne perputhje me kriteret e parashikuara ne nenin 113, paragrafi (1) i Ligjit per Shoqëritë Tregtare.

Neni 7

Regjistri i aksionareve dhe Certifikatat e aksioneve

7.1 Shoqëria, nen pergjegjesine e Administratorit, do te hartojë dhe mbajë nje regjister te aksionareve te Shoqërisë ne seline e saj, i cili duhet te permbajë: emrin, mbiemrin dhe te dhenat identifikuese personale te aksionarit ose, nese aksionari eshte person juridik, emertimin dhe te dhenat identifikuese te personit juridik, numrin e aksioneve, vleren nominale te tyre, barra/pengje apo te drejta te tjera siguroese te regjistruara mbi aksionet, adresen ose seline e aksionareve dhe daten e kryerjes se regjistrimit te aktit. Adresa e komunikuar Shoqërisë nga aksionari me shkrim, ne formen e aktit noterial, dhe e regjistruar ne regjistrin e mesiperm, do te prezumohet si adresa e tij zyrtare ne te cilen do te dergohen te gjitha komunikimet ne lidhje me Shoqërine dhe/ose kete statut deri ne momentin kur aksionari do t'i njoftojë Shoqërisë me shkrim (ne formen e aktit noterial) ndryshimin e saj.

7.2 Aksionari ka te drejte te kerkojë nje certifikate per aksionet e zoteruar prej tij. Certifikata nuk do te gezojë cilesine e letres me vlere. Aksionari i Shoqërisë autorizon shprehimisht, me hyrjen ne fuqi te ketij statuti, perfaqesuesin ligjor te Shoqërisë te leshojë certifikata aksionare ne perputhje me regjistrin e aksionareve.

Neni 8

Zmadhimi dhe Zvogelimi i Kapitalit Themeltar

8.1 Asambleja e Pergjithshme, me shumice te kualifikuar, mund te zmadhojë kapitalin themeltar te Shoqërisë, nepermjet kontributeve ne para ose ne natyre, ne vleren e percaktuar ne vendimin perkates, ne perputhje me Ligjin.

8.2 Shoqëria mund te vendosë zvogelimin e kapitalit themeltar te saj me vendimin e Asamblese se Pergjithshme, te marre me shumicen e kualifikuar te votave dhe ne perputhje me

parashikimet e Ligjit.

Neni 9

Trasferimi i te drejtave te lidhura me Aksionet dhe i pronesise se tyre

9.1 Titulli i pronesise mbi aksionet, mund t'i transferohet paleve te treta, te cilat nuk jane aksionare te Shoqerise, *inter vivos*, vetem ne perputhje me procedurat ketu te percaktuara.

9.2 Çdo aksionar i cili deshiron te transferoje te drejtat e tij mbi nje apo me shume aksione qe ka ne pronesi ("**Shitesi**"), duhet paraprakisht te njoftoje me shkrim (i) Shoqerine, ne vemendje te Administratorit dhe Keshillin te Administrimit dhe (ii) te gjithe aksionaret e tjere ("**Aksionaret e Tjere**"), duke derguar nje leter rekomande ("**Njoftimi**") ne seline e Shoqerise dhe ne adresat e aksionareve sikurse te regjistruara ne regjistrin e aksionareve. Ne rast te kundert, Njoftimi do te konsiderohet i pavlefshem.

9.3 Njoftimi duhet te specifikoje: (a) emrin e pales se trete/bleresit potencial si dhe te dhena te tjera mbi aktivitetin e blesit; (b) aksionet e ofruara dhe (c) cmimin e rene dakord per cdo aksion. Cdo kusht dhe term shtese per te cilet eshte rene dakord midis Shitesit dhe pales se trete do te jete detyrues kundrejt aksionareve te cilet ushtrojne te drejtat e tyre te parablerjes.

9.4 Aksionaret e Tjere kane te drejte te blejne te gjitha, por jo pjese te aksioneve te ofruara, me te njejtin cmim te shenuar ne Njoftim. Nese Aksionaret e Tjere kane si qellim te ushtrojne te drejten e parablerjes, secili prej tyre duhet te njoftoje Shitesin permes nje letre rekomande me kthim pergjigje, e cila duhet te derghohet brenda 40 diteve kalendarike prej dites se marrjes se Njoftimit. Nese sa me siper nuk do te njoftohet brenda afatit te mesiperm, e drejta e parablerjes do te konsiderohet si e dorehequr.

9.5 Ne rastin kur e drejta e parablerjes ushtrohet, Shitesi duhet te transferoje pronesine e aksioneve tek Aksionari Tjeter (i cili ka ushtruar te drejten e parablerjes) dhe cmimi perkates duhet te paguhet nga ky i fundit ne favor te Shitesit, brenda 40 diteve kalendarike duke filluar nga skadenca e periudhes pergjate se ciles mund te ushtrohet kjo e drejte e parablerjes. Nese cmimi ne fjale nuk paguhet brenda afatit te mesiperm, e drejta e parablerjes se ushtruar humb cdo efekt dhe kjo e drejte konsiderohet si e dorehequr.

9.6 Nese me shume se nje prej Aksionareve te Tjere ka ushtruar te drejten e parablerjes, aksionet e ofruara do te blihen prej ketyre Aksionareve ne perpjesetim te drejte me aksionet perkates qe ata kane pronesi ne Shoqeri.

9.7 Nese asnje prej Aksionareve te Tjere nuk ka ushtruar te drejten perkatese te parablerjes brenda afatit te siperpercaktuar, apo nese kane mbetur aksione mbi te cilat nuk eshte ushtruar kjo e drejte, Shitesi do te kete te drejte t'i shese aksionet e specifikuar ne Njoftim (ose aksionet e mbetura) tek Bleresi potencial me cmimin aty te percaktuar. Shitesi nuk mund te shese aksionet tek Bleresi potencial me kushte me te favorshme, perfshire ulje ne cmimin e shitjes, nga ato te ofruara tek Aksionaret e Tjere. Ne rast se Shitesi ndryshon kushtet duke i bere me te favorshme ateherë kjo do te konsiderohet si shitje e re dhe procedura e te drejtes se parablerjes se Aksionereve te Tjere sipas ketij neni do te perseritet, ne rast te kundert do te konsiderohet si shkelje e te drejtes se parablerjes.

9.8 Kushtet e parashikuara ne kete Nen nuk do te zbatohen tek marreveshjet e transferimit midis aksionareve, si dhe ne rastin kur subjekti (qofte person juridik, person fizik ose individ) te cilit i transferohen aksionet:

(i) kontrollohet, drejtperdrejte ose terthorazi, prej transferuesit/ve vetem ose bashkarisht me nje prej aksionareve te tjere te Shoqerise;

(ii) eshte nje subjekt i cili drejtpersedrejte apo terthorazi kontrollon transferuesin/at apo nje prej aksionereve te tjere te Shoqerise;

(iii) subjektit/et te cilit i eshte kryer transferimi dhe transferuesi/at jane nen kontrollin e perbashket te te njejtit subjekt te trete;

(iv) eshte bashkeshort/e, femije, prind, vella ose moter e tij ose e bashkeshortit/es, femije i femijes, i transferuesit ose eshte nje subjekt i kontrolluar nga to;

per sa kohe eshte dhene evidence per kontrollin sipas (i), (ii), (iii) dhe (iv).

9.9 Per me shume qartesi, aksionaret deklarojne se per qellimin e kesaj dispozite, "kontroll"

do te thote te zoterosh direkt ose indirekt shumicen absolute te votave ne Asamblene e Pergjithshme te shoqerise target (d.m.th. 50% plus 1 vote). Transferimi i titullit te pronesise se aksioneve me ane te dhurimit behet vetem midis paleve te percaktuara ne kete paragraf 9.8.

9.10 Ne te gjitha rastet e tjera kur ky statut ose Ligji nuk ndalojne ose kufizojne shprehimisht transferimin e aksioneve, aksionet mund te transferohen lirisht.

KREU III

ORGANET E SHOQERISE DHE KOMPETENCAT

Neni 10

Organet e Shoqerise

10.1 Organet e Shoqerise jane:

- 1) Asambleja e Pergjithshme;
- 2) Keshilli i Administrimit;
- 3) Administratori/et dhe
- 4) Ekspertet Kontabel te Autorizuar.

Neni 11

Asambleja e Pergjithshme

11.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi vendimmarres i Shoqerise dhe perbehet nga te gjithë aksionaret e saj.

11.2 Çdo aksionar ka te drejten te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme, te shprehe mendimin e tij dhe te ushtroje te drejten e votes qe buron nga aksionet qe zoteron. Gjithsesi, asnje aksionar nuk do te votoje ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme, personalisht ose nepermjet perfaqesuesve, ne lidhje me aksionet e zoteruara prej tij, nese nuk ka shlyer teresisht detyrimet qe kane te bejne me aksionet brenda afateve te percaktuara ne kete statut ose nga organet e Shoqerise.

11.3 Çdo aksionar mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme nga nje person tjetër, jo domosdoshmerish aksionar, ne baze te nje prokure me shkrim. Ne cdo rast, prokura mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese te Pergjithshme, dhe eshte e vlefshme per cdo thirrje te saj.

11.4 Nje aksionar nuk mund te leshoje nje prokure per nje pjese te aksioneve kur ai eshte i pranishem dhe te votoje personalisht per pjesen tjetër te ketyre aksioneve.

Neni 12

Thirja, mbledhja dhe drejtimi i Asamblese

12.1 Asambleja e Pergjithshme thirret nga Keshilli i Administrimit sa here qe te jete e nevojshme per interesat e Shoqerise ose ne rast se kerkohet nga aksionaret qe zoterojne te pakten 5% (pese perqind) te kapitalit ose Ligji. Ne cdo rast, Asambleja e Pergjithshme duhet te thirre te pakten nje here ne vit, brenda muajit Qershor, me qellim diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin e bilancit vjetor te vitit ushtrimor te meparshem.

12.2 Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme duhet te behet me leter rekomande me njoftim marrjeje, te derguar ne adresen e aksionareve te regjistruar ne regjistrin e aksionareve, ose me poste elektronike me njoftim marrjeje ne adresen elektronike te aksionareve te pakten 21 (njezet e nje) dite perpara dates se caktuar per mbledhjen e asamblese.

12.3 Njoftimi duhet te permbaje informacion mbi ceshtjet qe do te diskutohen dhe mbi te cilat do te merret vendim, vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte, si edhe procedurat e detajuara te pjesemarrjes dhe te votimit, informacion mbi vendin dhe menytrat e marrjes se dokumentacionit dhe projekt vendimeve te asamblese si edhe elementet e tjera te percaktuara nga legjislacioni ne fuqi.

12.4 Asambleja e Pergjithshme mund te mbledhet ne nje vendndodhje te ndryshme nga selia e Shoqerise, brenda ose jashte Republikes se Shqiperise.

12.5 Asambleja e Pergjithshme mund te mbahet edhe me pjesemarrjen e personave ne vende te ndryshme, nepermjet nje telekonference apo video konference, ose mjete te tjera elektronike te ngjashme, me kusht qe te gjitha te pranishmit te mund te identifikohen dhe t'u jepet mundesia per te ndjekur diskutimet, per te marre pjese ne to si dhe per te konsultuar e shkembyer dokumente. Asambleja mund te votoje edhe nepermjet shprehjes se votes me shkrim nga ana e aksionerti apo nepermjet vendimit qarkullues (ne kete rast data e mbajtjes se Asamblese do te konsiderohet data e vendosur ne njoftim).

12.6 Asambleja e Pergjithshme mund te drejtohet nga nje aksionar i emeruar me votim nga shumica e aksionareve te pranishem ose te perfaqesuar ne mbledhje ose mund te drejtohet nga administratori nese keshtu vendoset nga kjo shumice e aksionareve. Gjithashtu, Asambleja e Pergjithshme duhet te emeroje nje sekretar (edhe ne menyre te perhereshme), i cili mund te mos jete domosdoshmerish nje prej aksionareve, por mund te jete edhe nje punonjes i Shoqerise.

12.7 Kryetari i mbledhjes ka kompetenca te plota per te kontrolluar prokurat dhe vlefshmerine e tyre, te drejten e aksionareve dhe perfaqesuesve te tyre per te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme, dhe per te percaktuar nese asambleja eshte mbledhur rregullisht dhe nese eshte arritur kuorumi i domosdoshem per te marre vendime te vlefshme.

12.8 Kryetari ka gjithashtu te drejten per te drejtuar diskutimet dhe percaktuar metodat, procedurat e votimit dhe numerimit te votave. Verbalizimi ne procesverbalin e mbledhjes i diskutimeve, i kuoromit te pjesemarrjes dhe te vendimarrjes, nga ana e Kryetarit te mbledhjes dhe Sekretarit perben prove perfundimtare te ketyre fakteve, me perjashtim te rastit kur nje aksionar kerkon shprehimisht te verbalizohet tekstualisht qendrimi i tij ose kundërshton menyren e numerimit te votave te aplikuar nga Kryetari. Ne kete rast ne procesverbal verbalizohet cfare eshte kerkuar shprehimisht nga aksionari dhe numerimi i votave kryhet duke verbalizuar cdo vote.

12.9 Vendimet, procesverbalet dhe lista e pjesemarrjesve do te pergatiten pas cdo asambleje dhedo te nenshkruhen nga kryetari dhe sekretari i asamblese, si edhe noteri nese kjo kerkohet nga ligji apo nga shumica e aksionareve. Administratori do te jete pergjegjes per te siguruar qe vendimet/procesverbalet/lista e pjesemarrjesve te hartohen dhe nenshkruhen pa vonese pas cdo asambleje por jo me vone se 3 (tre) dite pune nga data e mbajtjes se saj.

Neni 13

Kuorumi dhe kompetencat e Asamblese se Pergjithshme


13.1 Asambleja e Pergjithshme ka kompetencat qe Ligji dhe ky Statut i njohin shprehimisht asaj. Ne perputhje me parashikimet ligjore, per qellimin e llogaritjes se kuoromit dhe te votave te cilat nevojiten per miratimin e vendimeve, perqindja e te drejtave te votes ne Asamblene e Pergjithshme per secilin nga aksionaret do te jete si me poshte:

(a) Shoqëria “Arch Investor” sh.p.k, zoteron 100 % te votave ne Asamblene e Pergjithshme;

13.2 Përveç rasteve te parashikuara ne nenin 13 pika 13.3 e ketij Statuti, vendimet e Asamblese se Pergjithshme jane te vlefshem nese te pranishem (ose te perfaqesuar) ne mbledhje jane aksionaret me te drejte vote qe perfaqesojne me shume se 30% te aksioneve te Shoqerise dhe vendimet miratohen me voten pro te aksionareve qe perfaqesojne te pakten 50% + 1 vote, te aksioneve te pranishem (ose te perfaqesuar) ne mbledhje.

13.3 Vendimet e Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me ceshtjet e meposhtme jane te vlefshem nese te pranishem (ose te perfaqesuar) ne mbledhje jane aksionaret qe perfaqesojne 50% +1 vote, te aksionareve te Shoqerise dhe vendimet miratohen me voten pro te aksionareve qe perfaqesojne te pakten 75% te votave te aksionareve qe jane te pranishem (ose te perfaqesuar) ne mbledhje:

a.modifikimi i Statutit;



- b. zmadhimi e zvogelimi i kapitalit te Shoqerise;
- c. krijimi i kategorive te aksioneve apo ndryshimi i tyre;
- d. shnderrimi, riorganizimi, likuidimi dhe prishja e Shoqerise;
- e. bashkimi, perthithja ose ndarja e Shoqerise;
- f. emetimi i obligacioneve te konvertueshme dhe i obligacioneve;
- g. vendimet per shperndarjen ose mos shperndarjen e dividendeve;
- h. rastet e tjera te parashikuara shprehimisht dhe ne menyre te paderogueshmenga Ligji.

Neni 14 **Keshilli i Administrimit**

14.1 Keshilli i Administrimit ("Keshilli") perbehet nga 3 anetare individe, te emeruar me shumice te thjeshte nga Asambleja e Pergjithshme sipas menyres dhe propozimeve te percaktuara ne kete Statut, shumica e te cileve duhet te jene te pavarur.

14.2 Keshilli percakton nder anetaret e tij Kryetarin dhe Nen/Kryetarin. Mandati i anetareve te Keshillit zgjat 3 (tre) vjet dhe mund te shtyhet deri ne mbledhjen e radhes ne te cilen, sipas afateve te legjislacionit ne fuqi, Asambleja e Pergjithshme do te miratoje llogarite financiare (rezultatet) te vitit financiar paraardhes. Anetaret e Keshillit te Administrimit shkarkohen me shumice te thjeshte nga Asambleja e Pergjithshme.

14.2 Anetaret e pare te Keshillit te Administrimit do te jene:

1. Z. Niko Leka, me nr personal G10331096G, ne cilesine e anetarit;
2. Z. Kristian Leka, me nr personal J61012056W, ne cilesine e anetarit;
3. Z. Eno Zeneli, me nr personal I30828189D, ne cilesione e anetarit;

Neni 15 **Mbledhjet e Keshillit te Administrimit**

15.1 Keshilli mblidhet sa here qe eshte e nevojshme, ne perputhje me kerkesat e legjislacionit shqiptar, por jo me pak se 4 (kater) here ne vit. Kryetari therret mbledhjet e Keshillit dhe drejton seancat. Ne rast te mungeses se Kryetarit, mbledhjet e Keshillit thirren dhe drejtohen nga Nen/Kryetari. Mbledhjet e Keshillit thirren edhe me kerkesen e te pakten dy nga anetareve te tij. Procedura e thirrjes se mbledhjes se Keshillit do te jete nepermjet njoftimit me shkrim derguar anetareve te Keshillit jo me pak se 3 (tre) Dite Pune perpara, se bashkume rendin e dites dhe te gjitha materialet dhe dokumentet e nevojshme per mbledhjen. Ne rast urgjence, mbledhja mund te thirret edhe 1 (nje) dite perpara dates se caktuar per mbledhjen.

15.2 Keshilli mund te mbahet edhe me pjesemarrjen e personave ne vende te ndryshme, nepermjet nje telekonference apo video konference, ose mjete te tjera elektronike te ngjashme, me kusht qe te gjitha te pranishmit te mund te identifikohen dhe t'u jepet mundesia per te ndjekur diskutimet, per te marre pjese ne to si dhe per te konsultuar e shkëmbyer dokumente. Keshilli mund te votoje edhe nepermjet shprehjes se votes me shkrim nga ana e anetarit apo nepermjet vendimit qarkullues (ne kete rast data e mbajtjes se Keshillit do te konsiderohet data e vendosur ne njoftim).

15.3 Ne cdo mbledhje te Keshillit, kuorumi i kerkuar do te konsiderohet se ekziston nese te pranishem jane me shume se $\frac{1}{2}$ e anetareve dhe vendimet do te miratohen me voten miratuese te shumices se anetareve te pranishem ne mbledhje.

15.4 Cdo anetar ka nje vote te barabarte ne Keshill. Me qellim reflektimin e diskutimeve dhe vendimeve te marra ne mbledhje nga Keshilli, mbahen procesverbale, te cilat duhet te firmosen nga Kryetari dhe duhet te hartohen dhe nenshkruhen menjehere dhe jo me vone se 3 (tre) dite pune nga data e mbledhjes. Ne procesverbale duhet te pasqyrohet gjithashtu edhe mendimet

kunder vendimeve te marra. Procesverbali permban (ose i bashkelidhet nje dokument me vehte i nenshrkuar nga Kryetari) listen e anetareve pjesemarrres. Keshilli mund te emeruje edhe nje sekretar i cili do te asistojte me organizimin e mbledhjeve te Keshillit. Sekretari mund te jete i perhershme dhe mund te perzgjidhet nga personat e punesuar ne Shoqeri.

15.5 Keshilli ka te gjitha kompetencat dhe tagrat ne lidhje me administrimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem i cili eshte i nevojshem per arritjen e qellimeve te Shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe i rezervohen organeve te tjera nga Ligji ose Statuti. Keshilli mund t'ia delegoje pjeserisht keto tagra dhe kompetenca administratorit te Shoqerise ose prokuratoreve te posacem te saj.

15.6 Keshilli eshte pergjegjes, nder te tjera, edhe per kontrollin dhe mbikeqyrjen e administrimit te Shoqerise me qellim qe te siguroje qe aktiviteti i Shoqerise dhe veprimtaria e saj te jene ne perputhje me Ligjin dhe kete Statut. Keshilli, nder te tjera, ka kompetencen qe te kryeje inspektime dhe kontrole ne cdo kohe qe do ta mendoje te nevojshme si dhe te kerkoje te gjitha dokumentet qe i konsideron te nevojshme per permbushjen e detyrave te tij. Keshilli mund te miratoje, rregullore per proceduren e funksionimit te mbledhjeve si dhe te vendimarrjes ne to, ne perputhje me ligjin dhe Statutin.

15.7 Keshilli mund te krijojte komitete te posacme, te perbera nga anetaret e tij, per te pergatitur mbledhjet apo vendimet ose per te kryer funksione mbikeqyrje te caktuara. Komitetet i raportojne Keshillit.

15.8 Anetareve te Keshillit do te mund t'iu paguhen shpenzimet e udhetimit, akomodimit dhe shpenzime te tjera ne lidhje me pjesemarrjen e tyre ne mbledhjet e organeve te shoqerise ose te komiteteve te tyre, ne lidhje me permbushjen e detyrave te ngarkuara dhe funksioneve.

15.9 Keshilli, nder te tjera, me qellim listues dhe jo shterues, ushtron edhe funksionet e meposhtme te cilat nuk mund t'i delegohen administratorit ose te treteve:

- a. Emeron dhe shkarkon Administratorin/ret;
- b. Mbikeqyr aktivitetin e Administratorit dhe siguron qe ai te permbushe udhezimet e Asamblese, te Keshillit si dhe te zbatoje detyrat e ngarkuara nga Ligji dhe Statuti;
- c. Pergatit, me kerkese te Asamblese se Pergjithshme, marrjen e masave, qe jane ne kompetence te kesaj te fundit, i rekomandon asaj vendime te nevojshme per t'u marre, si dhe zbaton vendimet e Asamblese se Pergjithshme;
- d. Therret mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme sa here vleresohet e nevojshme per interesat e Shoqerise;
- e. Kujdeset qe Shoqeria te respektojte ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- f. Miraton planin vjetor te aktivitetit dhe te buxhetit vjetor te Shoqerise;
- g. Shqyrton e kontrollon librat kontabel, raportet e Administratorit/eve, dokumentet dhe aktivet e Shoqerise;
- h. Siguron qe pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurise se veprimtarise, si dhe detyrimet e tjera te raportimit e publikimit, te detyrueshme ne baze te ligjit apo statutit, te kryhen dhe mbahen me saktesi nga administratori/ret. Keto dokumente duhet te miratohen nga Keshilli per t'iu paraqitur Asamblese se Pergjithshme, se bashku me nje raport te Keshillit per miratim dhe nje pershkrim per mbikeqyrjen e administrimit gjate te gjithe vitit financiar;

- i. Siguron qe auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabel te kryhet te pakten nje here ne vit nga ekspertet kontabel te autorizuar, te pavarur, dhe raporti i auditimit, drejtuar Asamblese se Pergjithshme, t'u vihet ne dispozicion te gjithe anetareve te Keshillit. Raporti i Keshillit, permendur ne paragrafin 15.7 (h) te ketij neni, duhet te permbaje edhe mendimin per raportin e auditimit;
- j. Miraton marrjen persiper te detyrimeve me vlere me te larte se 5 per qind te asetave te shoqerise, sic rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara, nepermjet cfaredolloj instrumenti te borxhit;
- k. Miraton propozimin per themelimin e shoqerive tregtare ose te grupeve te reja si dhe cdo lloj pjesemarrje ne kapitalin e shoqerive te tjera;
- l. Miraton paraprakisht cdo qendrim vendimarrës te Shoqerise ne cilesine e ortakut/aksionarit te shoqerive te tjera tregtare apo grupeve;
- m. Miraton rregulloret e brendshme te Shoqerise;
- n. Kryen veprime te tjera, te percaktuara ne Ligj dhe ky Statut.

Neni 16 Administratori

16.1 Keshilli zgjedh nje ose me shume individe si Administratore te Shoqerise per nje periudhe 3 (tre) vjecare, ne pajtim me parashikimet e nenit 158 te Ligjit. Cdo ndryshim i Administratorit/reve ose i numerit te tyre nuk do te konsiderohet si ndryshimi Statutit.

16.2 Në perputhje me Nenin 158 (2) dhe 207 te Ligjit , Administratorët e Shoqerise meme nuk mund të emerohen si administratore të një shoqerie të kontrolluar dhe anasjelltas. Emerimet e bera ne kundërshtim me kete dispozite do te jene te pavlefshme.

16.3 Administratori i Shoqerise ne momentin e miratimit te ketij Statuti, eshte:

- **Z. Eno Zeneli i identifikuar me karten e identitetit me Nr.035083478 dhe nr personal I30828189D.**


Neni 17 Kompetencat e Administratorit/eve

17.1 Administratori do te jete pergjegjes per ceshtjet e administrimit te perditshem te Shoqerise, ne perputhje me kompetencat dhe tagrat e percaktuara nga ky Statut dhe Keshilli i Administrimit. Shoqeria merr persiper angazhime me nenshkrimin e Administratorit, sipas kufizimeve te parashikuara nga Ligji, Statuti dhe vendimi perkates i Keshillit.

17.2 Çdo delegim kompetencash nga administratorët mund te kryhet ne perputhje me kushtet qe mund te vendosi Keshilli. Administratorët nuk mund te delegojne detyrimet e tyre ligjore dhe statute si dhe ato te ngarkuara nga Keshilli, me perjashtim te rastit kur vendimi i ketij te fundit parashikon shprehimisht ndryshe.

Neni 18 Shperblimi, Perfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratoreve

18.1 Nese Keshilli vendos te shperbleje anetaret e Keshillit, dhe/ose Administratorin/et, ato do te shperblehen ne baze te skemes se vendosur nga Keshilli ne perputhje me parashikimet e nenit 160 te Ligjit.



Neni 19

Konflikti i Interesit

19.1 Administratori/et nuk do të lidhe/in marreveshje ose do të hyje/ne në marredhenie të tjera me Shoqerine në të cilat ata kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material dhe/ose që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e Shoqerisë, me përjashtim të rastit kur respektohet neni 13 i Ligjit dhe, në vecanti, deri në momentin kur miratohet nga Këshilli dhe i njoftohet sipas ligjit Asamblese së Përgjithshme.

19.2 Parashikimet e mësipërme, në përputhje me nenin 13 të Ligjit, aplikohen edhe në rastin kur në konflikt interesi real ose potencial në lidhje me Shoqerinë ose vendimin përkatës së ndodhet edhe një anëtar i Këshillit. Në këtë rast, anëtarët i Këshillit në konflikt interesi nuk duhet të marrë pjesë në votimin për miratimin e veprimit në fjalë dhe nuk llogaritet në kuorum.

Neni 20

Procesverbalet e mbledhjeve dhe regjistrat e Shoqerisë

20.1 Administratori/et kujdesen për plotësimin dhe mbajtjen e Regjistrat të Aksioneve si dhe që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet e vendimit të gjitha mbledhjeve të Asamblese së Përgjithshme dhe të Këshillit.

20.2 Administratori/ret përgjigjen edhe për hartimin brenda 3 ditësh pune nga data e mbledhjes të vendimeve të Asamblese si dhe ruajtjen e tyre.

Neni 21

Eksperti kontabel i autorizuar

21.1 Auditimi i jashtëm, i Shoqerisë kryhet nga 2 (dy) ose më shumë eksperte kontabel të autorizuar të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme për një vit financiar.

21.2 Në momentin e miratimit të këtij Statuti ekspertët kontabel të autorizuar të Shoqerisë do të jenë:

- Auditues Ligjore Znj. Mimoza Ferzaj P.F e regjistruar me NUIS K91527002D dhe Licencë nr.280, me adresë Tiranë, Rruga Tish Dahia, pallati i ri KIKA, 3/3/1.

Neni 22

Viti financiar

22.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti.

Neni 23


Fitimet

23.1 5% (pese për qind) të të ardhurave neto sikurse rezultojnë prej pasqyrave financiare vjetoredo të zbriten dhe ruhen si rezerva ligjore, deri sa kjo rezerva të jetë e barabartë me 10% (dhjetë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqerisë. Pjesa e mbetur do të mund të përdoret në bazë të vendimit përkatës të Asamblese së Përgjithshme për t'u shpërndarë si dividend apo dhe për qëllime të tjera të cilat do të konsiderohen si më të nevojshme apo për shpërndarje prej saj.

23.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të krijojë rezervë të tjera të jashtëzakonshme ose specifike.

23.3 Pas plotësimit të parashikimeve të nenëve 127 dhe 128 të Ligjit, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblese së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendeve në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionareve.

23.4 Me vendim të Asamblese së Përgjithshme që vendos në përputhje me Statutin dhe



melegjislacionin trgetar, fitimet mund te mos shperndahen tek aksionaret si dividende dhe te destinohen per qellime te tjera siç mund te vendose Asambleja e Pergjithshme.

23.5 Cdo aksionar, ne kete Statut deklarone dhe pranon duke nenshkruar kete Statut, dhe/ose duke u bere aksionar i Shoqerise, se duke pranuar dispozitat e ketij Neni 23 i cili lejon Asamblene e Pergjithshme te vendose mbi mos shperndarjen e dividenteve, ai po ushtron plotesisht te drejten qe i perket atij si aksionar dhe zoterues i aksioneve te Shoqerise, te njohur nga legjislacioni shqiptar, si zoterues te kapitalit aksionar perkates.

23.6 Fitimet llogariten ne perputhje me parimet e miratuara me Ligjin Nr. 9228 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar.

Neni 24 Prishja-Likujdimi

24.1 Shoqeria mund te priset per shkaqet e parashikuara nga ligji. Ne rast prishjeje, Asambleja e Pergjithshme, ne perputhje me nenin 13.3, emerone nje ose me shume likuidatore duke u caktuar kompetencat perkatese.

Neni 25 Njoftimet

25.1 Njoftimet e kryera nga cdo person sipas parashikimeve te Statutit, duhet te jene me shkrimose nepermjet komunikimit elektronik ne adresat e regjistruara te Shoqerise dhe jane te vlefshme ne lidhje me kohen e njoftuar per kete qellim dhe personin qe kryen njoftimin, me perjashtim te rasteve kur ky Statut parashikon shprehimisht ndryshe.


25.2 Shoqeria mund te njoftoje nje aksionar personalisht ose duke e derguar njoftimin me leter porosi me kthim pergjigje ne adresen e regjistruar te aksionarit qe i eshte njoftuar shoqerise nga ky i fundit. Kur ka disa bashkezoterues te nje aksioni, te gjitha njoftimet i jepen perfaqesuesit te tyre te perbashket sipas Ligjit.

Neni 26 Dispozita Perfundimtare

26.1 Ceshtjet qe nuk parashikohen shprehimisht nga ky Statut do te rregullohen nga ligji shqiptar per Shoqerite Tregtare.

AKSIONARI I VETEM:

Për: Shoqeria Arch Investor shpk



Z.Niko Leka
Administrator



Date 18.11.2025